




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Duke u bazuar në Ligjin për Komisionin e Pavarur të Mediave Nr. 04/L-44, konkretisht në Nenin 3, paragrafi 1, pika 2.6 dhe 2.11 dhe nenin 9, Komisioni, në takimin e mbajtur me datën 29 korrik 2021 nxjerr këtë:

**VENDIM**

- I. **NDËRPRITET** pezullimi i lëshimit të licencave për Ofrues të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale me transmetim përmes rrjetit të Operatorëve të Shpërndarjes;
- II. **MBETET NË FUQI** procedura për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale (KPM-2017/02).

**Arsyetim**

- III. Komisioni i KPM-së me datën 23 mars 2021 ka marr vendim për pezullimin e lëshimit të licencave për Ofrues të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale (OSHMA) me transmetim përmes rrjetit të Operatorëve të Shpërndarjes, me qëllim që të rishikohen procedurat dhe kriteret për licencë për këtë kategori të OSHMA-ve.
- IV. Komisioni me qëllim të rishikimit të procedurave dhe kriterëve për licencim ka iniciuar procedurën për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale (KPM-2017/02).
- V. Duke marr për bazë faktin se pas inicimit të procedurës për ndryshimin e Rregullores janë vërejtur çështje të cila kërkojnë kohë me të gjatë për vlerësimin dhe se procedurat për ndryshimin e kësaj Rregullore dhe rishikimi i kriterëve për licencim kërkojnë kohë relativisht të gjatë dhe konsultime me praktikantët tjerë, Komisioni vendosi që pezullimi i lëshimit të licencave të ndërpritet, në mënyrë që kërkesat eventuale për licencim të trajtohen dhe kandidatet potencial të pajisen me licenca transmetimi deri në hyrjen në fuqi të Rregullores së re.
- VI. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet pjesërisht vendimi i datës 23 mars 2021, konkretisht pika I.
- VII. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Xhevat LATIFI  
Kryetar  
Komisioni i Pavarur i Mediave



29.07.2021  
data

